

Eni KAÇI, Brunilda TAHIRI
REVISTA “DITURIJA” E MID’HAT FRASHËRIT, RIKTHIM NË
LEXIMIN E NJË ‘ENCIKLOPEDIË’

Abstrakti: Botimi i revistës “Diturija : e përkohshme shqip literare dhe diturake” themeluar dhe botuar nga Lumo Skendo (pseudonimi letrar i Mid’hat Frashërit), erdhi në një moment vendimtar për kulturën dhe botën shqiptare, pikërisht një muaj pas mbajtjes së “Kongresit të Manastirit”, duke lënë gjurmën e saj të pashlyeshme në historinë dhe rrjedhën e shtypit shqiptar. Ajo përbën një monument kulture të pashoq, e risjellë përmes botimit të saj anastatik, u jep mundësinë lexuesit të sotëm të bëhen ‘këndonjësit’ e tij të privilegjuar.

Duke pasur parasysh kontributin dhe veprën e jashtëzakonshme të Mid’hat Frashërit, përmes këtij artikulli synojmë të sjellim një ndihmesë në thellimin e njohjes së kësaj enciklopedie të mirëfilltë albanologjike, si dhe punës së intelektualit të rrallë, i fundmi i Frashërllinjve

Fjalë kyçe: Revista “Diturija”; Mid’hat Frashëri; Albanologjia; Shtypi shqiptar.

Hyrje

Rëndësia e jashtëzakonshme e informacionit, si parimi thelbësor i punës së bibliografisë dhe bibliotekave në vetvete, ishte shtysa kryesore në hartimin e bibliografisë së revistës “Diturija”, që synon të ndërtojë një njohje të thellë dhe shteruese bibliografike të saj. Ky artikull vjen si rezultat i rileximeve të revistës gjatë punës për hartimin e kësaj bibliografie, duke tentuar gjithashtu, një njohje më specifike të veprës mbresëlënëse të Mid’hat Frashërit, si dhe për të risjellë në vëmendjen e lexuesve vlerat e çmuara të saj.

Rikthim në leximin e një enciklopedie

Botimi i revistës “Diturija : e përkohshme shqip literare dhe diturake” themeluar nga Lumo Skendo (pseudonimi letrar i Mid’hat Frashërit), erdhi në një moment vendimtar për kulturën dhe botën shqiptare, pikërisht një muaj pas mbajtjes së “Kongresit të Manastirit”, duke lënë gjurmën e saj të pashlyeshme në historinë e shtypit shqiptar. Ajo përbën një monument kulture të pashoq, që rivjen për lexuesin e sotëm përmes botimit të saj anastatik, i ndërmarrë gjatë vitit 2018 nga Bibliotekat Kombëtare të Shqipërisë dhe Kosovës dhe Fondacioni ALSAR, botim ky që risjell në dritën e leximeve dhe studimeve të sotme vlerat e çmuara të kësaj reviste si dhe kontributin e jashtëzakonshëm të themeluesit të saj, Mid’hat Frashëri.

Mid’hat Frashëri, bir i patriotit Abdyl Frashërit dhe nip i Naimit dhe Samiut, është një nga personalitetet më të rëndësishme të botës shqiptare, intelektual i jashtëzakonshëm, i bruahtur me dashurinë e pakushtëzuar për atdheun, me një kulturë të pashoqë, bibliofili i rrallë gjeti shprehjen e tij të plotë në revistën “Diturija”. Në komunikimin me Këndonjësit në dy vjetorin e revistës, Mid’hat Frashëri e ndiente për detyrë ‘rrëfimin’ e qëllimit të këtij botimi, programin që frymëzon redaksinë e saj : “Në shkrimet e saj revista jonë, nga më i gjati gjer në më i shkurtër artikull,

ka për qok shërbimin e Shqipërisë dhe të shqiptarismësë. Ky program zhvillohet në tema historike, filologjike si dhe në shënimet e vegjël bibliografikë: T'i bëjmë këndonjësit tanë të shohin të shkuarën dhe të mejtohenë mbi pritmin, të kupëtojnë detyratë që i bienë kolektivitetit dhe çdo individit, të munt të marrë një formë të caktuarë përgjegjësi dhe aspiratat t'ona, të mësojmë çë duamë dhe çë lipset të duamë. Me këtë mënyrë përpiqemi që botimi ynë të jetë aq i dobishëm për njerinë privat, për nëpunësin si dhe për mësonjësin ose profesorin: kemi dashur t'u drejtohem të gjithëve" [1].

Numri i parë i revistës "Diturija" u botua më 1 janar 1909 në Selanik, fillimisht si një e përkohshme e përmuajshme. Rrethanat historike, por edhe ato jetësore, ndikuan në periodicitetin e botimit. Pas një ndërprerjeje 7-vjeçare, në vitin 1916 ajo rinisi të botohet, këtë herë e zhvendosur në Bukuresht dhe vetëm 3 muaj, qershor-gusht. Botimi i revistës u ndërpre sërish për të rinisur pas 10 vitesh, në nëntor 1926 në Tiranë deri në mbylljen e saj në dhjetor të vitit 1929. Megjithëse me një jetë jo të gjatë, vetëm 42 numra dhe rreth 1135 faqe, "Diturija" ishte një revistë që reflektonte erudicionin dhe kulturën e thellë të drejtuesit të saj, por edhe qëllimin dhe vizionin e qartë që Mid'hat Frashëri kishte për të. Pjesa kryesore e artikujve janë pa autor, por ai deduktohet në një nga komunikimet e tij me Këndonjësit e revistës në shënimin në nr. 1 të Diturisë së vitit 1926, sipas së cilit: "Do ta themi një herë për gjithënjë se, artikujt e Diturisë që skanë një nënshkrim janë të Drejtorit të saj" [2].

Në vitin e saj të parë revista "Diturija" përngjason me një 'mozaik' informacioni të pasur nga shkrime mbi çështjen kombëtare, artikuj mbi fenomenet natyrore; kuriozitete dhe dije mbi vende të ndryshme apo ngjarje historike; artikuj mbi shkencën, botanikën, astronominë, këshilla e fjalë të urta, por edhe krijime të poetëve kombëtare si Gjergj Fishta dhe Ndre Mjeda, etj. Shkrimet e para karakterizohen nga tema të lidhura me ngjarjen e rëndësishme të përcaktimit të alfabetit të gjuhës shqipe. Artikulli që çel revistën, "Istori e shkrimit shqip", nga pena e Mid'hat Frashërit, vjen si një dëshmi e rëndësishme që kishte në ato vite çështja e gjuhës shqipe. Jo pa qëllim ai sjell përmes këtij artikulli historinë e alfabetit; tekstet e vjetra shqipe; Shoqërinë e Stambollit; kontributin e Hahnit, Geitlerit, Budit, Bardhit, Bogdanit, Kristoforidhit, Kavaliotit, De Radës, Veqilharxhit e Naim Frashërit. Shkrimet e Lumo Skendos mbi këtë çështje vijnë duke prekur edhe problematika të tjera thelbësore që lidhen me përdorimin e gjuhës shqipe; drejtshkrimin dhe drejtshqiptimin; me domosdoshmërinë dhe nevojën e unifikimit të saj, si në shkrimet: "A do të kemi një të vetëm gjuhë literare shqip?", "Të vëmë re kur shkrojmë", etj.

Në vitet pasuese, ajo nis të formësohet si një revistë me artikuj të fuqishëm dhe studime shkencore, të cilat pasqyrojnë edhe rritjen cilësore dhe pjekurinë e revistës. Në faqet e saj vijnë hulumtimet e leximeve të thelluara, analizave shkencore nga më të larmishmet, të cilat janë të organizuara në rubrikat : *Andej-Këtej*; *Bibliografi*; *Bibliografi Shqipëtare* : shtim në radhëj i *Emile Legrand-it*; *Tribunë gramatike dhe gjuhësije*; *Udhëtarët e huaj në Shqipëri gjer në fund të shekullit 19-të*; *Aktiviteti i shqiptarëve në Rumani*; *Shqiptarët në Greqi*; *Libra të marra*; *Pjesa shtëpiake*. Mid'hat Frashëri ishte pena kryesore e "Diturisë" dhe shkroi e botoi me pseudonimin Lumo Skendo, por

me të bashkëpunuan edhe 57 personalitete të shquara, duke dhënë një kontributit të vyer në këtë revistë si: Gjergj Fishta, Ndre Mjeda, Aleksandër Xhuvani, Hamdi Bushati, Karl Gurakuqi, Mehdi Frashëri, Eshref Frashëri, Kolë Kamsi, Mati Logoreci, Milo Duçi, Nilo Borgia, Josif Haxhimima, Grigor Vavako, Mustafa Villa, etj., apo albanologë e personalitete të shquar si Gustav Weigand, Theodor Ippen, Petar Skok, Fulvio Cordignano, Leon Rey, Luigi M. Ugolini, etj.

Përgjatë gjithë viteve të botimit të saj ajo u bë pasqyrë e problematikave të mprehta që po përjetonte kombi si dhe u shndërrua në një hapësirë e shkëmbimit të mendimeve dhe debatit shkencor të studiuesve shqiptarë dhe albanologëve të shquar, duke sjellë kontribute të vyera. Shkrimet shtrihen në fusha të ndryshme, që nga çështja kombëtare apo e kufijve të vendit, te arsimi shqip dhe historiku i shkollës shqipe, besimi dhe folklori, etnogeneza dhe prejardhja e gjuhës shqipe dhe dëshmi të shkrimit shqip, misionet arkeologjike, fillesat e hartimit të bibliografive, etj. Si një enciklopedi e vërtetë në faqet e revistës gjejmë 475 personalitete të kulturës dhe historisë, jo vetëm shqiptare por edhe asaj botërore, të cilëve u është kushtuar vëmendje përmes artikujve dhe shkrimeve, qofshin informacione mbi veprimtarinë e tyre historike, kulturore apo shoqërore, ose shënime e refleksione mbi veprat e tyre, etj. Të tilla janë edhe leximet e thelluara të Mid'hat Frashëri që shpërfaqen përmes shënimeve kritike në një nga rubrikat e rëndësishme për fushën e albanologjisë “Udhëtarë të huaj në Shqipëri gjer në fund të shek. 19”. Në të lexuesi njihet me dëshmitë dhe veprat unike të udhëtarëve të huaj që gjatë periudhave të ndryshme kanë vizituar e qëndruar në tokën shqiptare edhe hapësirat ballkanike, si Lorenzo Bernardos, Arnold von Harfit, Jacobes Spoon, Francois Pouqueville, George G. Byron, Ami Boué, Henry Holland, Ibrahim Manzour, Smart Huges, William M. Leake, August van Grisebach, etj.

Rëndësia dhe domosdoshmëria e hartimit të një bibliografie shqiptare ishte një nga shqetësimet e mëdha të intelektualit Mid'hat Frashëri, çka pasqyrohet në rubrikën aq të rëndësishme “Bibliografi”, një punë e mirëfilltë shkencore bibliografike që ishte pjesë e pandarë e revistës që në numrin e saj të parë deri në përmbyllje. [3]. Në artikullin “Për shkrime të haruarë dhe të paditurë” [4] Mid'hat Frashëri ngre edhe një herë një nga çështjet më thelbësore të identitetit kombëtar, dëshmia dhe dokumentimi i historisë së shkrimit shqip. Duke vlerësuar punën e prof. Emile Legrand në hartimin e një bibliografie shqiptare, bibliofili i rrallë shpreh domosdoshmërinë e hartimit të një bibliografie shqiptare, për gjurmimin dhe dokumentimin e gjuhës shqipe. Botimi në faqet e revistës në një rubrikë të posaçme “Bibliografi shqiptare – shtim në radhëj i Emile Legrand” përbën një nga kontributet më të vyera të tij, jo vetëm për botimin e një vepre të çmuar si Bibliografia e Emile Legrand, por mbi të gjitha për pasurimin e saj me vepra të tjera të rëndësishme për historinë e shkrimit dhe botimit shqip, kulturën e kombi shqiptar. Burimi kryesor që e ndihmoi drejtuesin e revistës në hartimin e bibliografive ishte padyshim Libraria “Lumo Skendo”, thesari i së cilës, tashmë, është edhe një nga pjesët më të rëndësishme të fondit të vlerave të rralla dhe të arkivit të Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë. Krahas bibliotekës personale dhe librarisë së “Lumo Skendo” burime dhe ndihmesë kanë qenë edhe bibliotekat personale të intelektualëve dhe patriotëve shqiptarë si Karl Gurakuqi [5], Kristofori,

Mitropoli i Beratit [6], Lef Nosi [7], Cosmo Serembe [8], por edhe të diplomatit austro-gjerman Franz von Scheiger [9], etj., çka tregon një bashkëpunim dhe shkëmbim të ngushtë midis intelektualëve të kohës në zhvillimin dhe ruajtjen e kulturës dhe identitetit kombëtar. Këto të dhëna janë evidentuar nga botuesi në shënimet në fund të bibliografisë. Krahas plotësimit të Bibliografisë së Legrand, një zë po kaq të rëndësishëm janë edhe shënimet dhe analizat kritike të botimeve, jo vetëm libra por edhe periodikë, që pasqyroheshin në bibliografitë e hartuara prej Mid'hat Frashërit, të cilat shërbenin njëherazi edhe si këshilla për lexime dhe njohjen e tyre, gjë që dëshmon edhe një herë formimin e tij të gjithanshëm. Të tilla janë edhe rubrikat "*Duke kënduarë një libër*", "*Nga shkrimtarët dhe prej librave*", por edhe "*Udhëtarë të huaj në Shqipëri*".

Një vëmendje të madhe botuesi i kushton komunikimit me '*Këndonjësit*' e tij. Përmes shënimeve dhe njoftimeve të vazhdueshme që bënte në pjesën e brendshme të kopertinës së revistës, arrijmë sot të marrim një informacion të plotë mbi aktivitetin dhe jetën e revistës, pajtimet dhe shpërndarjen e saj, problematikat me të cilat ajo është përballur gjatë botimit, duke krijuar njëherazi, ndoshta edhe për herë të parë, një panoramë të qartë mbi punët botore të një periodiku shqip. Në këtë komunikim nuk mungojnë as njoftimet mbi botime të reja apo *grishjet* mbi ekspozitat, veprimtaritë dhe aktivitetet kulturore që zhvilloheshin në Librarinë "*Lumo Skendo*", të tilla si ekspozita mbi 50-vjetorin e Lidhjes së Prizrenit; ekspozitën me libra të vjetër shqip të botuar para vitit 1879; ekspozitës për Skënderbeun me rastin e festës së Shën Gjergjit, etj., çka dëshmojnë se kjo librari tashmë ishte shndërruar një vatër e kulturës kombëtare dhe atdhetarizmes. Ky komunikim i drejtpërdrejtë me lexuesin e tij, që reflekton qartazi vetëdijen e botuesit për rëndësinë e publikut, është i rrallë në historinë e shtypit shqiptar. Ashtu si kujdesi i tij për të dokumentuar çdo gjë që lidhej me ecurinë e botimit të kësaj reviste, e cila, ashtu si vetë Mid'hat Frashëri e parashikonte, në një të ardhme do të ishte aq shumë i vlefshëm për historinë e shtypit shqiptar [10]. Drejtori i revistës Lumo Skendo i drejtohet për herë të parë lexuesit përmes një komunikimi të shkurtër në pjesën e brendshme të kopertinës së parë në vitin 1916. Ky komunikim vjen edhe njëherë si një dëshmi e radhës për nevojën e dokumentimit të historisë kombëtare përmes dëshmimeve dhe dokumenteve, të cilat mund të jenë ruajtur nga njerëzit [11], për të vijuar më tej në komunikime të vazhdueshme në të gjithë numrat e saj, deri në komunikimin e fundit me ta : "*Kam uzdajë se miqt e mij kuptojnë që botimi i një reviste, dhe sidomos i një se përkohëshmeje si jona, nuk është një interprizë fjeshtë tregtare. Për neve kjo është një gjë intelektuale, kulturele, patriotike...*" [12].

Imazhi është një element shumë i rëndësishëm i revistës. Përgjatë gjithë vitit të parë të saj janë publikuar 27 fotografi, të cilat padyshim mbartin një vlerë të jashtëzakonshme, edhe si dëshmi historike e kulturore. Të tilla janë edhe fotografitë e Kongresit të Manastirit [13], Komisionit të alfabetit [14] apo faksimilja e vendimit të Komisionit mbi çeljen e abecese [15]. Por po kaq vlera mbartin edhe fotografitë me pamje të zgjedhura nga qytetet shqiptare të asaj periudhe si Berati, Shkodra, Elbasani, Shkupi, Tirana, Saranda, Gjirokastra, Dodona, Janina, Paramithia, apo qytetet arbëreshe në Itali, si Çivita apo Spezzano Albanese; monumente kulturore dhe kulti si

teqe, kisha, xhami, ura të vjetra; fotografi të jetës social-kulturore në vend, kryesisht në Korçë dhe Vlorë, apo foto të veshjeve tradicionale shqiptare të krahinës së Shkodrës. Pjesë e tyre janë edhe faksimilet. Mid'hat Frashëri ishte i vetëdijshëm për rëndësinë që ka historia dhe dokumentimi i saj. Jo pak herë përmes shkrimeve të tij ai u drejtohet lexuesve të revistës dhe ngre shqetësimin për dokumentimin e historisë së kombit, ruajtjen dhe arkivimin e tyre si dhe i fton në mbledhjen e dokumenteve të vjetra apo edhe dëshmime të ndryshme, që lidhen me ngjarje të rëndësishme historike.

Përgjatë gjithë botimit të saj, drejtuesi i kësaj reviste u kujdes të përfshinte në të informacione nga të gjitha fushat e dijes njerëzore, ku tematika e artikujve u organizua në formë rubrikash nga kuriozitetet, veprimtaria e gjerë të diasporës shqiptare, polemika dhe debate mbi tema delikate të botës shqiptare, letërkëmbime me lexuesit, shëndeti dhe të dhëna mbi kujdesin, analiza mbi çështjet ekonomike, biografi mbi personalitete të kulturës dhe historisë shqiptare dhe asaj botërore, por nuk mungojnë edhe informacione shkencore e kulturore apo kuriozitete mbi ngjarjet apo vende të tjera. Këta artikuj janë shoqëruar njëherazi edhe me refleksione apo vlerësime mbi to. Po ashtu edhe shënimet dhe shpjegimet në fund të faqeve, që janë bashkëshoqëruese të pothuajse të gjithë artikujve të saj, janë një element i veçantë i revistës *“Diturija”*, duke theksuar kështu rëndësinë që kishin të gjitha temat e trajtuara në artikujt e botuar dhe mendimi intelektual i një niveli të lartë shkencor.

Çdo faqe e kësaj reviste është një thesar informacioni, dije e çmuar në histori, udhëpërshkrim, shkencë, gjuhësi, ekonomi, arsim, folklor, bibliografi, kritikë, imazh, që gjithmonë i vlen publikut në lexime të reja dhe të cilat çelin udhë për njohjen e thellë dhe të plotë të një prej figurave më të spikatura të kombit shqiptar, atdhetarit dhe intelektualit të rrallë Mid'hat Frashëri. Përmes botimit të plotë anastatik të revistës *“Diturija”*, por edhe bibliografisë shteruese që i bashkëngjitet leximit të revistës, hidhet një hap drejt një *‘rizbulimi’* aq të vyer të kësaj enciklopedie, e cila nuk iu nda asnjë çast qëllimit të saj *‘diturak kombiar’*.

Përfundime

“Diturija” është një nga revistat më të rëndësishme në shtypin shqip, studimi i thelluar i saj është ende i pashtershëm. Për herë të parë në faqet e një periodiku shqip nis në formësohet ideja e rëndësisë dhe domosdoshmërisë së hartimit të një bibliografie shqiptare, një shqetësim i vazhdueshëm i bibliofilit Mid'hat Frashëri. Kjo pasqyrohet në artikujt e tij si dhe në rubrikën *“Bibliografi”*, e cila pa frikë mund të cilësohet si një punë e mirëfilltë shkencore bibliografike.

Po kaq i jashtëzakonshëm është edhe komunikimi i vazhdueshëm dhe i drejtpërdrejtë me lexuesit, i rrallë në historinë e shtypit periodik shqiptar, çka reflekton vetëdijen e botuesit për rëndësinë e publikut, por njëherazi, është i vlefshëm edhe në informacionet mbi aktivitetin dhe jetën e revistës, të cilat janë dokumentuar më së miri nga botuesi dhe vijnë si një dokument unikal në historinë e shtypit. Kjo vetëdije e Mid'hat Frashërit për rëndësinë e dëshmime dhe

dokumentimit historik, reflektohet edhe në hapësirën që u jep fotografive në faqet e revistës, si një element i jashtëzakonshëm i saj, po aq i rrallë në fillesat e periodikut shqip dhe aq pak i studiuar.

Revista “Diturija” përbën një enciklopedi të pashoqe, ku informacionet nga të gjitha fushat e dijes njerëzore, u organizuan në rubrika të veçanta. Mirë-organizimi i tyre dëshmon për erudicionin dhe punën skrupuloze të drejtuesit si dhe nivelin e saj shkencor, duke e shndërruar atë në një thesar të vyer dijesh e informacioni, që edhe sot, pothuaj 110 vite më pas, mbetet një ‘rizbulim’ i çmuar.

Bibliografia

- Skendo, L. Diturija, nr. 12, 1928. Shënim në rubrikën “Këndonjësit” që mban datën 31 gusht 1928.
Diturija, nr. 1, Vol. II, 1 nantor 1926, f. 40.
Diturija, nr. 1, 1 janar 1909, f. 16.
Diturija, Vol. II, nr. 2, korrik 1916, f. 20.
Diturija, Vol. II, nr.2, 1 dhjetor 1926, f. 80.
Diturija, Vol. II, nr. 9, 10, 11, korrik, gusht, shtator 1927, f. 359.
Diturija, Vol. II, nr.6, 1 prill 1927, f. 80.
Diturija, Vol. III, nr.9, 10, 11, korrik, gusht, shtator 1928, f. 358.
Diturija, Vol. III, nr.9, 10, 11, korrik, gusht, shtator 1928, f. 357.
Diturija, Vol. IV, nr. 3, dhjetor 1929, f. 120.
Diturija, Vol. II, nr. 2, korrik 1916.
Diturija, Vol. IV, nr. 3, dhjetor 1929, f. 120.
Diturija, nr. 3, 1 mars 1909, f. 40.
Diturija, nr. 3, 1 mars 1909, fl. 1 pas f. 40.
Diturija, nr. 3, 1 mars 1909, fl. 2 pas f. 40.